



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 43 datë 29-05-2025

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË
DATËS 24 PRILL 2025**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës **24.04.2025** në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

V E N D O S I

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës **24.04.2025** bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 29-05-2025



K R Y E T A R E

Ana VERUSHI

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 24 PRILL 2025

Kryesuesi I mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 25

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 25

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo dhe drejtorë të administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita të gjithëve, mirë se keni ardhur në mbledhjen e rradhës të këshillit bashkiak. Kalojmë në pikën e parë miratimi i rendit të ditës, kush është dakort?

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 24 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 27 MARS 2025.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës.

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1-31 MARS 2025.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare A.Taho: Komisioni është mbledhur ditën e martë ka informacionin e duhur nga drejtoria sociale, për muajin mars për fondin e vënë në dispozicion përfitojnë ndihmë ekonomike nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike 51 familje po nga ky fond përfitojnë kompesim të energjisë elektrike 23 familje dhe 18 familje përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, komisioni ka vendosur t'ja kalojë materialin këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit komisioni, ka diçka nga këshilltarët nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 4 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË BUXHETIT DHE PËRDORIMIN E FINANCIMIT NGA TRANS ADRIATIC PIPELINE AG (TAP-AG) PËR OBJEKTIN “SHTRIM I RRUGËVE ME KALLDRËM NË LAGJET “SARAQ”, “DUKAS” DHE “GREKAS” NË VITHKUQ.

Këshilltar L.Petri: Për procedurë znj.kryetare.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Urdhëro.

Këshilltar L.Petri: Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës vë në pah para kolegëve këshilltarë që informacioni nga ana e sekretares të këshillit bashkiak ka erdhur dy ditë para.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po, ndërkohë që rendi i ditës ka qënë aty, unë e kam pasur të paktën ditën që kemi bërë mbledhjen e kryesisë.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Në fakt Lazjoni ka të drejtë e kisha shkarkuar dhe marrëveshjen dhe relacionin në një file dhe file nuk ishte ngarkuar ngaqë ishte shumë i madh por tek materialet e fotokopjuara ishte dhe materialet ishin gati që atë ditë dhe prandaj kemi dy versione dhe email sepse në email mund të ndodhin edhe probleme që nuk janë në dorën tonë dhe kush ka erdhur e ka marrë materialin ka parë që është në dosje i printuar që atë ditë që është shpërndarë, materiali ka qënë.

Këshilltar L.Petri: Ok unë pashë vetëm materialin elektronik dhe ju bazova atij.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Ndaj unë dje e ndava relacionin më vete dhe marrëveshjen më vete pasi ishin në një file dhe nuk ishin ngarkuar i gjithë informacioni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit sekretaria, fjala për komisionin.

Këshilltar A.Habip: Bashkia Korçë ka bërë një marrëveshje Shoqërinë “Trans Adriatic Pipeline” në datën 7 mars 2025 që përkon me financimin e kësaj shoqërie, projekti për shtrimin e rrugëve me kalldrëm në lagjet “Saraq”, “Dukas” dhe “Grekas” të Vithkuqit kjo marrëveshje do sjellë rritjen e planit të buxhetimit

dhe përdorimin e këtij financimi vlera është 4 milion e 980 mijë e 574 lekë të cilat ky fond i ka kaluar bashkisë në datën 21 mars dhe do të rrisë planin e buxhetimit, komisioni në shumicë vendosi ta kalojë me dy vota pro dhe një kundër për seancën e këshillit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

Atëherë z.Bregu më pas z.Lazjon.

Këshilltar E.Bregu: Pyetja ime e parë ishte që me dy vota pro dhe një kundër kalon apo nuk kalon?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem mikrofonin sepse nuk dëgjohet.

Këshilltar E.Bregu: Pyetja ime e parë ishte që me dy vota pro dhe një kundër kalon apo nuk kalon sepse në komision janë 5-7 anëtarë dhe duhen të paktën 3 vota.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Vetëm 3 veta kanë qënë megjithatë është këshilli ai që vendos, shqyrtohet edhe njëherë materiali në këshill më pas vendoset, ai dha mendimin ndoshta u shpreh Altini gabim.

Këshilltar E.Bregu: Duhet të shprehet saktë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ai tha mendimin ne jemi mbledhur vetëm tre veta kanë qënë ranë dakort apo jo, vetëm një lapsus ne materialin do e shqyrtojmë këtu

Këshilltar A.Habip: Më fal znj.kryetare por në komision unë jam i detyruar të shpreh dhe votën e këshilltares sepse ka...

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Dakort por ideja ishte që nuk kishte mazhorancë komisioni pra nuk janë mbledhur me shumicë.

Këshilltar A.Habip: Kourumi është me 3 veta.

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Sipas rregullores një komision kur janë 5 anëtarë komisioni quhet i mbledhur kur ka kourumin prej 3 anëtarësh dhe çdo lloj "vendimmarrje" që merr komisioni quhet me shumicën e anëtarëve që janë prezent në komision.

Këshilltar E.Bregu: Me shumicë të thjeshtë do të thuash?

Këshilltar D.Osmeni: Nëse ky apo komisionet e tjera nuk mblidhen si procedohet me materialin?

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Diskutohet në këshill.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E thashë edhe më parë është këshilli ai që vendos.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar E.Bregu: Nuk ka vlerë domethënë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ai ka vlerë për gjithë ata këshilltarë që nuk kanë eksperiencën e nevojshme, arsimin e duhur për atë fushë dhe mund të pyesin në komision dhe kur të vijnë në komision të jenë të sqaruar në mënyrë që mos stërzgjetemi gjatë seancave të mbledhjeve të këshillit. Vazhdoni me pyetjen tuaj?

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me financimin e Trans Adriatic Pipeline (TAP) që e quajmë doja të dija nëse marrëveshja është nënshkruar tani apo ka një ligj që rregullon këtë lloj marrëveshje para se të nënshkruhet marrëveshja për sasinë e financimit, mënyrën, objektet e financimit pra këtë financim sot

TAP e ka sjellë sepse ja do qejfi dhe e sjell sepse ja ka kërkuar bashkia, apo është e bazuar në një marrëveshje qeveritare ka një ligj për këtë punë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Më fal z.Kryetar të bëjë dhe pyetjen tjetër se mbase janë në një linjë. Lazjon ju kishit pyetje?

Këshilltar L.Petri: Unë kisha pyetje edhe për komisionin edhe për ekzekutivin. Pyetja e parë lidhet me shumën e financimit pse është 50 mijë euro, është bërë ndonjë prevetiv që shtrimi i rrugëve do shkojë kaq?

Pyetja e dytë lidhet përsëri me këtë çështje në lidhje me dëmin që ka shkaktuar në fshatin Vithkuq, kalimi i TAPIT për të cilat kemi marrë indicie nga banorët por edhe nga disa specialistë që Kisha e "Shën Millit" ka pësuar plasaritje flas për një objekt monument kulture dhe një kishë e nivelit sipëror të ortodoksisë, është llogaritur ndonjë dëm, pra ka ndonjë faturë dëmi financiar që ka shkaktuar TAP dhe si ka rezultuar kjo tek kjo marrëveshje pra është përmëndur që të bëhet dhe kompesimi i dëmit social-ekonomik por edhe kultëror që ka nodhur por mbi këtë edhe të gjendet ky financim si një lloj rregullimi?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje të tjera?

Këshilltar K.Pllaha: Ne e kemi prekur edhe herë të tjera çështjen e Vithkuqit përse i përket ujësjellësit dhe për mendimin tim shumë mire që po bëhet shtrimi i rrugëve por a nuk do ishte mirë që bashkë me shtrimin e rrugëve të bëhej para nëse ka nevojë edhe kanalizimet si për ujërat e pijshëm ashtu edhe për ujërat e përdorura para se të bëhej shtrimi me kalldrëm që mos bëjmë një punë dhe pastaj ta prishim pas disa vitesh përsëri?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atëherë po ju jap përgjigje, me financimin dhe me llojin e marrëveshjes nuk bëhet fjalë për ndonjë marrëveshje të madhe qeveritare, bëhet fjalë për një fond që ne si bashki ja kemi kërkuar prej disa kohësh më shumë se një vit mbase dhe dy vjet kompanisë TAP për të financuar një projekt tjetër në zonën e Vithkuqit që do ishte një studim për realizimin e një piste skish në këtë zonë të Vithkuqit por për shkak se ato kushtet në vlerësimin tonë nuk plotësoheshin maksimalisht i kemi kërkuar para disa muajsh që të bënte një rialokim të këtij fondi që na i kishte alokuar të bënte një rialokim tjetër në përfitim të komunitetit të fshatit Vithkuq që është shtrimi me kalldrëm i disa rrugëve në këtë fshat, nga një rrugë në çdo lagje është ideja kjo jep përgjigje dhe vlerës 5 milion lekë sepse ishte kjo vlerë 50 mijë euro që ishte alokuar fillimisht me qëllimin për të bërë studimin dhe meqënëse nuk na u nevojiti më për këtë të njëjtën shumë e rialokuam për qëllimin e dytë rikonstruksionin e rrugëve. Ideja është që atje do të kemi një bashkëpunim realizimin e projektit ndërmjet fondit të alokuar nga TAP edhe kontributit në materiale e bashkisë për të realizuar rikonstruksionin e këtyre tre rrugëve të cilat edhe janë inspektuar nga stafi i bashkisë dhe kemi arritur në konkluzionin që nëpërmjet kësaj ndarje të përgjegjësisë nga ana e bashkisë dhe fondit të TAP mund ta përmbyllim si proces. Përse i përket çështjes të ujësjellësit dhe kanalizimeve po dhe ne jemi të interesuar që në këto rrugë që do shtrohet të mos ndërhyrje për problematika të tjera dhe pjesë e inspektimeve në këtë rrugë ka qënë dhe stafi i ujësjellës kanalizimeve është bërë verifikimi i gjëndjes të ujësjellësit dhe kanalizimit në të tre këto rrugë dhe çfarë janë ndërhyrje për tu realizuar nga ana e ujësjellës kanalizimeve do realizohen para se të fillojë procesi i shtrimit të kalldrëmit, meqënëse u hap dhe çështja e ujësjellësit mbase e dini mbase jo në rast se nuk e keni dëgjuar unë po ja u them këtu, kam qënë personalisht i interesuar dhe kam lobuar le të themi pranë ujësjellës kanalizimeve që ne të bënim rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin e Vithkuqit kjo punë para disa vitesh është alokuar dhe vlera e caktuar për ta financuar këtë projekt, ka filluar dhe puna në teren po pastaj e kemi ndërprerë pasi komuniteti i fshatit nuk ishte dakort në ato momente që ta kishte këtë investim pasi kërkonin që rikonstruksioni i rrjetit të bëhej pa vendosur matësa pra mos mateshe sasia e ujit nuk e di sa e keni dëgjuar këtë por me keqardhje kemi qënë të detyruar ta ndërpresim projektin në ato

momente, tani shoh që ka një lloj reflektimi nga ana e kundërt e komunitetit pra besoj se një pjesë e madhe e duan këtë investim dhe përsëri jam interesuar dhe kam kërkuar nga ana e ujësjellësit që ta përfshijë këtë financimin e rrjetit për gjithë fshatin jo për tre rrugë në planet e së ardhmes gjithnjë duke bashëpunuar me komunitetin dhe duke u kuptuar edhe njëherë me situatën dhe mos bëjmë projekte që komuniteti për arsye të ndryshme nuk i mirëpret. Përsa i takon dëmeve të TAP-it në fshatin kjo është si temë shumë e madhe, patjetër që mesa kam ndjekur unë ecurinë e projektit të TAP-it ka patur problematika të ndryshme të dëmtimeve dhe në bashkëpunim me stafin e TAP-it jemi përpjekur ti adresojmë dhe nuk është se ka ndonjë çështje të pa sqaruar apo çështje të hapura dhe çështja e dëmtimit në kishën e “Shën Millit” është një nga çështjet që është trajtuar në atë moment janë bërë edhe ekspertiza dhe informacion të saktë tani për momentin nuk kam por e kujtoj që ka qënë një nga çështjet që e kemi trajtuar mund të marr një informacion edhe nga ana e TAP-it si është trajtuar, si është adresuar, çfarë përgjigje ju është dhënë dhe mund t’ja u jap në mbledhjen e radhës por nga ana tjetër ajo që duhet thënë është që përtej impaktit që mund të ketë pasur në dëmtime të caktuara projekti ka lënë edhe shumë gjëra të mira nga pas kur kryesorja është rikonstruksioni i plotë i rrugës nga Ura e Floqit deri në Shtyllë dhe më tutje pastaj deri në Panarit është projekt shumë i madh me vlerë disa miliona euro rikonstruksioni i kësaj rruge e cila do ishte e pamundur të bëhej nga financimi i bashkisë është bërë nga TAPI falë kërkesës të bashkisë pra në listën e projekteve komunitare ne i kemi kërkuar TAPI-it siç është edhe ky projekti i fundit me këtë vlerën modeste 50 mijë euro në kohën kur ka qënë duke implementuar projekti i madh ne si bashki i kemi kërkuar projektin edhe rikonstruksionin e plotë të rrugës, në rast se në kontratë kanë pasur vetëm riparimin e dëmeve që do të shkaktonin gjatë përdorimit të kësaj rruge, atje u bë rikonstruksioni i plotë i kësaj rruge e cila është një vepër që i ngeli jo vetëm Vithkuqit por gjithë zonës, për kishën e “Shën Millit” marrim një informacion dhe ja u japim në mbledhjen e radhës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit z.Kreytar.

Këshilltar A.Përmeti: Dua t’ju rikujtoj kolegëve që kompania TAP është një kompani prestigjioze dhe shumë serioze dhe ne kemi qënë këtu në këshill që kemi miratuar dhe të tjera marrëveshje të TAP siç ishte ujëmbledhësa për bagëtitë në zona të thella malore prapë në këto fshatra gjithashtu edhe Muzeu “Gjon Milli” ka qënë një mbështetje me fondet e TAPI-it që është një vlerë e shtuar dhe atraksion për qytetin e Korçës.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk doja t’i lista të gjitha por meqënëse Ada i përmendi është e para rruga, e dyta Markata e Shijes ku TAP ka bashkëfinancuar një vlerë të konsiderueshme në rikonstruksionin e atij objekti, Muzeu i “Gjon Millit” është gjithashtu që bashkëfinancim i TAPIT kemi dhe projekte shumë të vogla të cilat TAPI i ka bërë në këtë zonë vitet e fundit me atë përgjegjësi sociale të korporatave ky është ai termi zyrtar që përdoret pra në projekte të mëdha që kanë impakt në komunitet kanë edhe pjesë të politikave të tyre që të bëjnë punë komunitetit dhe TAPI ka qënë nga ato kompani që i ka bërë këto. Mesa po kujtoj tani dhe riasfaltimi i rrugës të Drenovës, afaltimi i disa rrugëve Qatrom edhe Polenë janë bërë të gjitha me financim të TAP pra nuk është se nuk ka pasur punë në dobi të komunitetit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit z.Kreytar, ka diskutime nga këshilltarët?

Po z.Bregu fjala për ju.

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me TAP-in ne jemi shumë dakort që TAP ka bërë ndërhyrje dhe ndihmesa të mëdha në zonën ku kaluar ndaj në këtë pikë jemi falenderuese ndaj kësaj kompanie. Të vetmin gabim që ka bërë TAP.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Afroje pak më shumë se deri këtu nuk vjen zëri.

Këshilltar E.Bregu: Të vetmin gabim që ka bërë TAP është që ka bashkëfinancuar me Markatën e Shijes i cili është një investim totalisht i dështuar i kryetarit z.Sotiraq Filo.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ky është mendimi juaj, ka këshilltarë të tjerë që duan fjalën për diskutim?

Këshilltar L.Petri: Faleminderit znj.kryetare, falenderoj dhe kryetarin dhe kolegët për vlerën që ka sjellë TAP sigurisht kompani të tilla kanë atë përgjegjësi korporative dhe këtu nuk jemi që të jemi mosmirënjohës ndaj çfarë kanë bërë por të kërkojmë se çfarë mund të bëjnë më mirë. Fjala vjen në këtë marrëveshje u prek edhe nga kolegu Pllaha këtu është diskutuar vetëm për kalldrëmet kur e dimë që atje ka një problematikë edhe për ndriçimin. Ka një ndriçim të përgjithshëm edhe në Vithkuq por marrëveshje të tjera duhen parë edhe si oportunitet për të rritur cilësinë e jetës komunitare dhe rruga është një nga këto por nuk është e vetmja sigurisht që është e limituar dhe nuk mund të bëjmë diçka, nga ana tjetër dua të bëj një apel këtu pasi u informova nëpërmjet rrjeteve sociale që në prani të kryeministrit dhe miqve nga Ajzerbaxhani është bërë një marrëveshje dhe z.kryetar duhet të na thotë këtu se çfarë marrëveshje është bërë pasi nuk ka kaluar në këshill në lidhje me ngrohjen e qytetit të Korçës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem mo kalojmë në pika të tjera t'i përmbahemi rendit të ditës dhe të merrni informacione në fund fare.

Këshilltar L.Petri: Mundem znj.kryetare ta mbaroj fjalën?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po mundeni, por ju lutem t'i përmbaheni pikës të rendit të ditës dhe më pas në të ndryshme ta pyesni kryetarin edhe për të tjera.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në vijim të kësaj që thotë kryetaria e këshillit që mos hapim shumë diskutime brenda një pike, ka një temë të caktuar dhe mund ta diskutojmë në pika të tjera?

Këshilltar L.Petri: Jo z.kryetar pasi ajo lidhet me TAP-in.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ajo lidhet me TAP-in, me Socar, lidhet me Qeverinë Shqiptare, me Qeverinë e Ajzerbaxhanit me gjeopolitikën, tani këtu jemi për thelbin e pikës dhe kthehemi tek ajo, nuk po them mos e diskutojmë por ta diskutojmë në pika të tjera. Tani këtu një rialokim e kam bërë me ato që kam dëgjuar nga komuniteti në takimet që unë kam bërë kanë kërkuar ndërhyrje në rrugë dhe po sjell rrugë po të më kishin kërkuar ndriçim do e bëja ndriçim, ka rezultuar që komuniteti kërkon rrugë dhe po flasim për rialokim të kësaj vlerë as për vlere më të mëdha as për ngrohjen e Korçës po flasim rialokim të kësaj vlere, ta mbyllim njëherë këtë pastaj në pika të tjera më pyesni dhe përgjigjem, nuk po them nuk jemi hermetik për ngrohjen unë dua të flas për ngrohjen sepse kemi një projekt madhor por dua të flas në momentin që duhet.

Këshilltar L.Petri: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë në këshill e kaloj në momentin që duhet kaluar për gjëra që nuk kanë nevojë për tu kaluar në këshill i diskutoj por jo ta kaloj.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare e diskutojmë në të ndryshme.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje tjetër?

Këshilltar D.Osmari: Në vijim të diskutimit dua edhe nga kryetari por edhe nga kolegu im Klajdi është kërkuar më parë për investimin që duhet të bëhej tek Ujësjellës Kanalizime në Vithkuq dhe kryetari na tha këtu që ata sot kanë rënë dakort për ta parë edhe njëherë atë situatën që nuk pranonin të vendosnin masa apo jo?

Duke qënë se për këto tre rrugë nuk po them për rrugët e tjera por për këto tre rrugë ky investim që do bëhet me kalldrëm nëqoftëse nesër do vendoset sipas jush që të bëhet dhe investimi në Ujësjellës Kanalizime nuk mendoni që ok ky si fond të bëhet por të bëhet bashkë me investimin tuaj në Ujësjellës Kanalizime të paktën në këto tre rrugë pjesërisht që të mos çahen?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Devi me shumë dashamirësi mos ke qënë duke bërë ndonjë punë tjetër sepse e thashë këtë gjë e kemi parë me Ujësjellësin dhe specifikisht vetëm në këto tre rrugë do i shtrijmë tubat që mos i hapim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po z.Pllaha.

Këshilltar K.Pllaha: Më fal znj.kryetare do bëj një pyetje sepse tani u kujtova. Në lagjen "Saraq" ka filluar më duket shtrimi është bërë një pjesë, është rruga që lidh "Saraqin" me "Makërsin" në mos gaboj?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo.

Këshilltar K.Pllaha: Flitet për ndonjë rrugë tjetër?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Rruga brenda lagjes.

Këshilltar K.Pllaha: Jo rruga kryesore?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 29

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 29 këshilltarë, 29 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 5 e rendit të ditës.

PËR DETAJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltar A.Habip: Ministria e Mbrojtjes ka akorduar fondin e kushtëzuar Bashkisë Korçë në shumën 18 milion e 476 mijë e 565 lekë, ekzekutivi bazuar në kërkesat e Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike, Drejtorisë të Mbrojtjes Kundër Zjarrit dhe njësive administrative ka planifikuar detajimin e këtij fondi sipas këtyre zërave që unë do i lexoj. Shumën 2 mijë e 633 mijë e 565 lekë për rreth 214 ton kripë të cilat do përdoren për emergjencat dimërore, shumën 343 mijë që do përdoren për blerje të ndryshme për strukturat e mbrojtjes kundër zjarrit, gjithashtu ka vlerën 6 milion lekë të reja që do jenë për blerjen e mjeteve të reja dhe një fadrome po ashtu të re në vlerën 9 milion e 500 mijë lekë, komisioni edhe këtë vendosi me shumicë t'ja kalojë seancës të këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar I.Bode: Unë shikoj që është një blerje mjeti 6 milion por është ATP nuk është borëpastruese, ATP do të thotë që është një automjet për transport të përzierë pasagjerë dhe ngarkesa të vogla të ndryshme dhe nuk thotë borëpastruese. Unë kam përshtypjen do ishte mirë të kishte një borëpastruese me ato që pamë gjatë periudhës të dimrit ku asnjë makineri nuk ishte e përshtatshme dhe punëtorët shpërndanin kripën hipur majë kamionave duke thyer çdo rregull të sigurisë teknike, mirë do ishte të ishte një borë pastruese por mua nuk me rezultoi një e tillë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje të tjera sepse bëni pyetjen dhe komentin bashkë. Ka pyetje të tjera?

Këshilltar E.Bregu: Së pari mirë është të korrigjohet kjo pjesa e kripës që është 213. ca ton dhe 214 ton jo 214 mijë .

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është korrigjuar.

Këshilltar E.Bregu: Së dyti kisha një pyetje lidhur me këtë kripën, ne këtë kripën e blemë dhe e mbani gjendje në magazine apo e parapaguani dhe e tërhiqni kur ka nevojë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë përgjigje për këtë?

Përgjegjës i Emergjencave Civile A.Qazolli: Para se të bëhet ndarja e fondit që bazohet në dy vkm nr.414 datë 8.07.2021 dhe 290 në zbatim të këtyre vkm është bërë ndarja e këtij fondi të kushtëzuar. Kamion borëpastrues është miratuar dhe do blihet ka kaluar në Ministrinë e Financave dhe është në procedurë prokurimi, pra është blerë kamioni borëpastrues është miratuar nga Ministria e Mbrojtjes. Mjeti ATP është mjet për ngarkimin e materialeve, për marrjen e materialeve sidomos në Katund pas Vithkuqit dhe në Damjanec ku ishin dy zona tepër të vështira dhe kishin të pamundur mjete të tjera për të kaluar. Fadroma është parashikuar të përdoret në dy njësitë administrative që janë më me problem Vithkuqi (nuka kja audio) që kemi pasur problem të paktën në tre vitet e kaluara në ato ditë që ka rënë dëborë. Për pyetjen e dytë nga këshilltari është zvendësuar kripa që është harxhuar gjatë vitit të kaluar dhe duhet të kemi një sasi të caktuar kripe dhe njëkohësisht gjatë vitit një sasi kripe shpërndahet në njësitë administrative që janë Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Drenovë të gjitha të 7-ta siç janë kripa e harxhuar u zvendësua me sasinë e parashikuar.

Këshilltar E.Bregu: Kisha dhe një pyetje tjetër, këtu thotë për blerjen e kësaj ATP-së dhe fadromës prodhimi i vitit 2023 dhe 2024 pse është vendosur kufizimi 2024 nuk mund të jetë e 2025, ka ndonjë arsye pse është vendosur pse është vendosur ky segment?

Përgjegjës i Emergjencave Civile A.Qazolli: Këto janë parë në internet nga specialistët e Drejtorisë të Transportit Rrugor Korçë që të jemi të saktë dhe këto vite prodhimi nuk janë 2025 por janë 2020-2025 dhe prodhimi i fundit ishte 2023 këto mund të jenë prodhimi i 2025 por është seria e 2023.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të jap edhe unë një sqarim, ideja është ky është një fond i cili na kalon nga Qeveria, nga Agjensia Kombëtare e Emergjencave Civile për tu shpërndarë më pas me vendim të këshillit të bashkisë për gjërat që lidhen me emergjencat. Ne ja u kemi ndarë këtë material këtyre drejtorive që merren me këto çështje që mund të përkufizojnë si emergjenca kemi marrë kërkesat e tyre dhe ato që kanë renditur si më të rëndësishme i kemi sjellë për miratim sot. Për këtë mjetin ATP fiks çfarë është bërë një mesazh tani të na thonë çfarë lloj kamioni me çfarë specifikime por është një gjë që e kanë gjykuar se lidhet me punën në sezonin e dimrit kurse bore pastruesen e kemi aplikuar në një thirrje pra jo fond ka qënë thirrje që ka hapur përsëri Agjensia, kemi aplikuar atje për një borë pastruese na është miratuar dhe është në proces prokurimi pra dhe borë pastruese do marrim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, z.Osmani keni kërkuar fjalën?

Z.Pllaha keni diçka?

Këshilltar K.Pllaha: Në buxhetin që ne kemi miratuar për vitin 2025 nuk ishte parashikuar fondin e Ndërmarrjes të Shërbimeve Publike blerje e kripës për emergjencat dimërore duhet një fond i veçantë?

Buxheti i kësaj ndërmarrje me thënë të drejtën është i konsiderueshëm në buxhetin total të bashkisë dhe këto financime të tjera që vijnë nëpërmjet fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, zbriten nga ai buxhet paraprak?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po nuk ka problem se njësoj janë.

Këshilltar K.Pllaha: Jo ideja është mos harxhohen dy herë për të njëjtin qëllim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po si u harxhokan dy herë për të njëjtin qëllim domethënë a i buxheti i ndërmarrjes vërtet është i madh por edhe punët që do bëjë ndërmarrja janë të mëdha dhe ju buxhetin e ndërmarrjes dhe për çfarë do përdoret ai e keni në materialin e buxhetit që kemi miratuar në muajin dhjetor të vitit të kaluar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kripa nuk ishte.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në dijeninë time jo sepse ne vazhdimisht kripën e kemi marrë nga ky fond që na vjen nga emergjencat civile por edhe sikur të ishte patjetër nuk do merrej nga një fond por do merrej nga fond i tjetër.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, z.Osmani kishe diçka se unë ja u dhashë fjalën bashkë me pyetjet të bënit dhe diskutimet.

Këshilltar D.Osmani: Një diskutim kisha unë në lidhje me blerjen e kripës, gjatë viteve por edhe këtë vit konstatojmë që problemi i madh i qytetarëve të paktën në kuadër të problematikës kur bihen rreshje dëbore është që nuk hidhet kripë mjaftueshëm në qytetin e Korçës, shikoj se vlera nuk është ndonjë vlerë e madhe të blesh kripë besoj se kjo është megjithë transport sipas informacioneve time dhe më pak duhet të jetë lekë për ton po 2.6 milion lekë është një vlerë e konsiderueshme por mendoj se duhet ta rishikoni sepse ankesa të tilla kemi nga qytetarët çdo vit që ankohen për pjesën e kripës ose përzierjes të kripës me atë zhavorin nuk e di pse e bëni e shikojmë këtu në Shqipëri sepse në asnjë vend nuk e ngatërrojnë zhavorin me kripë, nuk e di çfarë shpjegimi keni, nëse ka një shpjegim nga juaj.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se për të tilla gjëra çfarë shpjegime ka, ngrohja është kështu që ngrohja e motit pra kështu që nuk ka bërë shumë dimër që të duhen sasi më të mëdha kripe.

Këshilltar D.Osmani: Nuk duhet?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kaq shumë sa ju mendoni.

Këshilltar D.Osmani: Nuk mendoj unë janë ankesat e qytetarëve, teorikisht konstatimi që kemi janë ankesa të tilla.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kjo lidhet nëse ka kryer kontraktori punën e dhënë.

Këshilltar D.Osmani: E them sepse ne shpenzojmë për të blerë makineri dhe pajisje, për të blerë borëpastruese apo kamionçina gjë që është normale dhe duhet bërë por edhe të shtohet ky fond i kripës unë mendoj që le të na ngelet pak kripë në fund të vitit sepse e përdorim sërish vitin tjetër.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 30

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 30 këshilltarë, 30 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 6 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË BUXHETIT NË VLERËN 500.000 LEKË PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “FOLK-KOLORATURË TË ANSAMBLIT ARTISTIK TË QARKUT TË KORÇËS SKËNDERBEU”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë komisioni, do doja që nga komisioni të vijnë relacionet e shkurtuara për të mos i bëjmë leximet e relacionit siç i ka dërguar ekzekutivi por atë ekstraktin që ka bërë komisioni në procesverbalin që ju mbani.

Këshilltar A.Habip: Këshilli i Qarkut në bashkëpunim me Bashkinë Korçë ka bërë një marrëveshje bashkëpunimi në datën 18 mars 2025 për të financuar një projekt të Folk-Koloraturë të Ansamblit Artistik projekti është 500.000 lekë dhe kjo do përdoret për të mbuluar shpenzimet në stafin organizativ kryesisht onoraret. Ky fond do i shtohet planit të buxhetit të bashkisë për artin dhe kulturën dhe premierat do zhvillohet në muajin prill dhe do jenë në Maqedoni dhe Kosovë, komisioni ka vendosur t’ja kalojë këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se shumë mire bën Këshilli i Qarkut që ndihmon Ansamblin. Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar D.Osmani: Tani në muajin prill aktual apo, se jemi në fund të muajit prill?

Këshilltar A.Habip: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni).

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po z.Pllaha.

Këshilltar K.Pllaha:Ky projekt ishte parashikuar në projektet e Qendrës të Artit dhe Kulturës dhe a ka pasur një fond të përcaktuar për këtë gjë, për buxhetim e kësaj qendre?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mund ta sqarojë z.Nexhipi, ka erdhur dhe Blerta, Blerta më fal sepse ka dhe një pyetje tjetër nga z.Lazjon.

Këshilltar L.Petri: Znj.kryetare nuk e shikoni të udhës që së bashku me këtë material të na bashkëngjisni edhe prevetin e aktivitetit sepse thuhet një marrëveshje atje me një vlerë të rrumbullakosur 500.000 lekë domethënë zero për zero shkon, mbase kaq mbështeten institucionet nga Këshilli i Qarkut është për tu vlerësuar bashkëpunimi ndër-institucional por duhet një respekt për këshilltarët e bashkisë që të bëhet më i detajuar materiali, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të paktën ne sot miratojmë kalimin e këtj fondi nga Këshilli i Qarkut, tani përse i përket detajimit ja ku është Blerta këtu dhe do ja u bëjë. Besoj se mbaruam me pyetjet sepse jam e

kujdeshme kështu, paska dhe një pyetje z.Osmani. Z.Osmani ngrije pak dorën mos e mbaj shumë ulur, presim të bëjë dhe një pyetje z.Osmani.

Këshilltar D.Osmani: Meqënëse e bëmë kështu po e bëj pyetje-diskutime që mos bëjmë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Marrim njëherë përgjigje.

Ekzekutivi B.Belliu: Ansambli Artistik "Skënderbeu" përveç se mbështetet nga bashkia çdo muaj me onorarin që ju e dini, ai ka disa ngjarje artistike, ka një premiere e cila sigurohet nga brenda qendrës ka nevojë për mbështetje të jashtme, një nga aktivitetet është premiera që bëhet çdo muaj në fundvit që mbështet nga Bashkia me 300.000 lekë të vjetra që unë mund t'ja u vë përpara patjetër ndërsa turret zakonisht janë mbështetur nga Qarku, znj.Ana e di këtë si ish-kryetare e Këshillit të Qarkut sepse kanë kosto, disa ftesa për Ansamblin në Kosovë, Maqedoni, Danimarkë do të shkojnë në fundvit dhe kostoja është shumë e madhe mbulohet nga bashkia një pjesë si ushqimi, fjetja, transporti por nuk majfton sepse pagesa që ofrohet nuk majfton për rregjizorin, korografin. Kjo nuk është pjesë e fushatës sepse është një ftesë që unë e kam dhe mund t'ja u vë në dispozicion që ka erdhur nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Një nga aktivitetet është bërë në Gostivar në datën 14 prill, tjetra mbahet në datën 30 prill është një ftesë e dërguar një vit më parë e cila nuk ka lidhje me pjesën e fushatës.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pyetja ishte cilat aktivitete do mbulohen?

Ekzekutivi B.Belliu : Një është mbuluar në Gostivar dhe njëra në Prishtinë në datën 30.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Cilat kosto do mbulohen?

Ekzekutivi B.Belliu : Aty ishte udhëheqësi artistik dhe gjitha onoraret, janë pjestarët e Ansambilit të cilët e kanë shtesë këtë përtej asaj që paguhet, pra është një mbështetje që duhet të jetë shtesë patjetër sepse nuk majfton gjithmonë për ture jashtë Korçë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po z.Osmani meqënëse e ka kërkuar më parë.

Këshilltar K.Pllaha: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon).

Ekzekutivi B.Belliu: Më fal nuk e kujtoj.

Këshilltar K.Pllaha: Pyetja ishte për këtë aktivitet a është parashikuar në projektet e Qendrës të Artit dhe Kulturës dhe a ka pasur një fond të përcaktuar për këtë gjë, për buxhetim e kësaj qendre?

Ekzekutivi B.Belliu: Dhe unë ta thashë që ftesat zakonisht nuk janë të parashikuara sepse varet kush na fton, nuk mund ta kemi këtë parashikim.

Këshilltar K.Pllaha: Pra nuk ka pasur një fond të parashikuar për këtë çështje.

Ekzekutivi B.Belliu: Jo aktivitetet jashtë Korçë e kemi të pamundur t'i parashikojmë pasi ftesat vijnë gjithmonë kur bëhen festivalet, ndërsa premierat e Ansambilit i kemi të parashikuara.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po z.Lazjon.

Këshilltar L.Petri: Më falni po pse qeshni?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Sepse e kërkoi Devi më parë edhe ndaj të lashë rradhën.

Këshilltar L.Petri: Vazhdo Devi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jo vazhdo.

Këshilltar L.Petri: Dua të pyes znj.Belliu sepse pak më përpara thatë që ftesa ka erdhur para një viti dhe tani Klajdit i thatë që e morëm vesh në fund, kur e morët vesh dhe a bëtë mbështetje buxheti kur e morët vesh?

Ekzekutivi B.Belliu: Ftesa ka erdhur para një viti por si ato ftesa ne na vijnë 30 në vit dhe ne i shikojmë sepse nuk mund të shkojmë në 30 vende dhe pasi unë u konsultova dhe thamë se nuk kemi mundësi nga bashkia për të mbështetur një Ansambël me 35 anëtarë në turne kërkuam ndihmë nga Qarku dhe mbasi ai më tha po u bëmë mundur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Vazhdo z.Osmani.

Këshilltar L.Petri: Ta mbyll fjalën meqënëse jam, jemi tek diskutimet znj.kryetare?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jemi tek pyetjet dhe diskutimet sepse i bëni bashkë bëni e komente mbi ato pastaj.

Këshilltar L.Petri: Unë po mbaj qëndrimin tim dhe po them se evente të tilla janë pasaportë për Korçën dhe unë vlerësoj këtë nismë duhet të ketë sa më shumë ura lidhëse por nuk më pëlqen procedura si bëhet, akordohet një fond thjesht për onorare është gjetur kjo 500.000 lekë dhe pastaj shkon vetëm për këtë onorar kur në fakt procedura sesi bëhet në parim unë e mbështes dhe falenderoj dhe kryetarin e Qarkut meqënëse është këtu që ju gjendet artistëve.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, z.Osmani.

Këshilltar D.Osmani: Ashtu si parafolëse dhe unë jam shumë dakort t'i mbështesim qoftë këtë lloj projekti por edhe të tjera në vazhdim. I vetmi problem dhe e kemi konstatuar gjatë kësaj periudhe është se do ju lutesha shumë meqënëse dhe drejtoresha është këtu do ju lutesha shumë që takimet, organizimet, eventet mos i përdorim për fushatë politike. Jo më pak se një javë e gjysëm para është bërë një takim i tillë me të rinjtë por të lutem të jesh më e kujdesshme, nuk ka nevojë për komente nuk duhet të jetë për asnjë forcë politike përdor të rinjte për fushatë, kaq nuk ka nevojë për shpejgim.

Ekzekutivi B.Belliu: Mund të përgjigjem?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ja një minutë, z.Nexhipi fjalën.

Këshilltar E.Nexhipi: Faleminderit, kisha menduar se nuk do flisja por meqënëse u hap diskutimi, në këtë rast vetëm për përdorim politik nuk bëhet fjalë, madje e kam promovuar personalisht sepse gjithmonë me merakun që nuk kam pse ngatërroj një aktivitet që i shërben jo vetëm artistëve por edhe atje ku kanë vajtur dhe ku do venë, i shërben atij urës të komunikimit që tha Lazjoni por është më shumë se kaq pasi kemi çuar një lloj vlere që atje për fat të keq qoftë në Gostivar apo dhe Prishtinë për fat të keq mungojnë. Nuk e di pse po i bëhet kaq rekalmë këtu por nuk është e nevojshme, për situatën që kemi për zgjedhjet politike sepse po të ishte për pjesën e përdorimit unë nuk e kam përmendur fare, ju mund të keni friendsa bashkë atje por nuk është vendi për ta cilësuar, megjithatë ju e dini bëjini rekalmë.

Këshilltar D.Osmani: Edhe njëherë nuk ishte për kryetarin e qarkut që Lazjoni e falenderoi por edhe unë e di znj.drejtoreshë për çfarë flas unë, e di kryetari për çfarë flas unë nuk doja ta bëja kaq të madhe.

Këshilltar I.Bode: Kryetarit të Qarkut po i përgjigjem fare thjesht nuk është se nuk ka ndodhur këto gjëra prandaj po pyesim, ai vetë e tha padashje që nuk është ky rasti për përdorim politik, pra raste ka pasur por nuk është ky. Pikërisht sepse ka pasur raste të tilla i referohem dhe Korit Lira në Selamik që janë përdorur për këtë punë, ju thoni çfarë të doni po.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kryetar e hedhim në votim dhe më pas mund të thoni diçka sqaruese. E hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 30 këshilltarë, 28 pro, 1 kundër, 1 abstenim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Dy fjalë meqënëse u përmendën dy aktivitee ku kam qënë prezent unë. E para ajo e Korit Lira në Selanik nuk e di nëse ka qënë prezent ndonjëri nga ju ose i afërmi juaj, por unë në atë takim unë nuk kam bërë asnjë thirrje politike as për të mbështetur ndonjë forcë të caktuar politike, madje nuk i kam përmendur fare as zgjedhjet, kam folur vetëm për rolin dhe peshën që emigrantët kanë patur historikisht dhe kanë në zhvillimet ekonomike, sociale që nodhin në Korçë dhe i kam falenderuar, vetëm kaq. Mundt ë kishit ardhur edhe ju dhe ta shfrytëzonit atë eventin dhe jut ë bënit ato thirrjet tuaja.

Këshilltar E.Bregu: Mund të bëj një pyetje?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ja se nuk kam mbaruar, kurse përse i takon atij takimit me një grup të rinjsh të Rin Showt më vjen keq që e bëni si takim politik, mund të pyesni ata të rinj nëse është përmendur diçka politike apo jo dhe pastaj hajdeni dhe më thoni, nuk e kisha unë si kryetar bashkia mua më ftuan. Dikush para se të jetë drejtues qarku është dhe qytetar i këtij qyteti dhe ka dhënë disa contribute të caktuara është i interesuar t'i dëgjojë. Më fal u bë ndonjë thirrje politike, u përmend ndonjë?

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë po flas për pjesën time, u bë në atë takim ndonjë ftesë?

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë të mbuloj ndonjë gjë që ka ndodhur, unë habitem si trajtoni çdo gjë si politikë nuk janë të gjitha gjërat politike.

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mos i përdorni më do të thotë që i keni përdorur.

Këshilltar E.Bregu: E vërtetë është i keni përdorur.

Këshilltar D.Osmani: Edhe njëherë nuk është e thënë të bëjmë debat dhe e kam anashkaluar këtë pjesë, në momentin që flasim ka ndodhur diçka dhe ju e dini më mire kanë qënë persona me shumë apo pak të drejtë ju e dini më mirë por nëqoftëse doni të bëni diçka që të përfshijë dhe të rinjtë dhe pjesën e politikës që është në garë mund të ftoje edhe dike nga ana tjetër nga opozita dhe kjo mbyllej.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Një takim e bën politik ajo çka thuhet në atë takim.

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani unë të dëgjova më ler të them dy fjalë ose ta bëjmë politike çdo gjë. Tani ky person që është person politik ngrihet në mëngjes fle në darkë dhe gjatë ditës të tij bën 100 gjëra nga këto 50 janë politike dhe 50 të tjera nuk janë politike. Tani në atë takim nuk është thënë asgjë politike, as

janë përmendur forcat politike, as ju është thënë të rinjëve të mbajnë ndonjë përkatësi të caktuar, ka qënë një bisedë, na ftuan hajdeni jemi këtu kemi bërë një bisedë mes të rinjsh, kryesisht Rin Show kaq. Tani në rast se ata të rinj donin të ftonin ndonjë person tjetër mund ta ftonin nuk ka asnjë problem.

Këshilltar D.Osmani: Ftesa ishte nga të rinjtë, jo nga drejtoresha?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nga cila drejtoreshë?

Këshilltar D.Osmani: Nga zonja që u largua tani.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ftesa ishte nga të rinjtë të shkonim të bënim një bisedë, asnjë fjalë për politikë.

Këshilltar D.Osmani: Nuk dua të ndërhy se çfarë është bisedar, biseda mund të ketë qënë e lirë dhe jam shumë dakort nuk po i hy kësaj pjese. Në momentin që po diskutojmë është përfshirja e të rinjve në këtë fushatë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit për sygjërimin, besoj se tani kaloi kjo pjesa për të diskutuar.

Këshilltar K.Pllaha: Mundem të them diçka?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jo se dolëm jashtë pikës të rendit të ditës, mbarojmë njëherë me rendin e ditës dhe mund të diskutojmë më pas sa të doni.

Këshilltar K.Pllaha: Meqënëse kryetari u zgjat kaq, mund të them një fjalë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jo të lutem sepse u zgjatëm shumë.

Këshilltar E.Bregu: Mos ja u ndërprit fjalën.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jo nuk ja u ka ndërprerë askush fjalën për të diskutuar jashtë pikave të rendit të ditës, Lazjon të lutem të kam dëgjuar të respektojmë rendin e ditës.

Këshilltar E.Bregu: Nëse nuk ja u jep fjalën këshilltarëve të opozitës do e braktisim sallën, kështu që mos prish mbledhjen e këshillit, kaq sa e ke zgjatur mund ta kishim mbyllur.

Këshilltar L.Petri: E kam për procedurë znj.kryetare.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka mundësi mos flisni z.Bregu, mbledhjen e drejtoj unë.

Këshilltar E.Bregu: Prandaj po ta kërkoj fjalën ty, ndryshe do ma kërkonte mua fjalën.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk ta kam ndërprerë fjalën kur ti ke dashur të flasësh sa të duash për pikën e rendit të ditës, jashtë kësaj pike nuk mundem.

Këshilltar L.Petri: E kam për procedurë znj.kryetare, ti nuk e di çfarë do them.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Sepse ne e votuam këtë pikë të rendit të ditës, më pas hapëm debate të tjera jashtë rendit të ditës, mbajeni mend çfarë do thoni dhe e diskutojmë në të ndryshme.

Këshilltar I.Bode: Më falni se nuk doja të ndërhyja me mikrofon, këshilltari po kërkon fjalën për procedurë kjo është brenda rregullores, ju nuk e dini se çfarë do thotë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit që ma sqaroni, unë po e sqaroj Lazjonin ta thotë në të ndryshme.

Këshilltar L.Petri: E kam në lidhje me këtë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kur pika e rendit të ditës votohet nuk ka më për të diskutuar për këtë pikë, për procedurë diskutoheni në të ndryshme.

Pika 7 e rendit të ditës.

SIPAS KËRKESËS TË SHOQËRISË “KORÇA 2008 SH.A” PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- PËR MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2024 TË SHOQËRISË “KORÇA 2008” SH.A.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Këshilli i administrimit të Shoqërisë “Korça 2008” ka dërguar për miratim pasqyrat financiare për vitin 2024, rezultatit financiar është me fitim 570 mijë e 364 lekë, këshilli mbikëqyrës ka vendosur ta kalojë për mbylljen e detyrimeve të prapambetura të cilat ka pasur kjo shoqëri ndër vite.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit Altin, ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar E.Bregu: I pashë me vëmendje pasqyrat financiare dhe këtu gjithashtu pashë dhe raportin e audituesve ligjorë dhe nuk ka asnjë shpjegim të detajuar për ta kuptuar askush sado profesionalisht të jetë nuk i kupton këto pasqyra, pse është ky borxhi i prapambetur cilët janë këta që kanë këtë borxh të prapambetur dhe po ta shikosh këtë raportin e audituesve ka një fletë me dy anë ku thuhet vetëm që është bërë sipas këtij apo atij standarti dhe nuk ka asnjë lloj informacioni, thjesht kjo është si një vulë noterie, e kemi marrë këtë pasqyrë financiare i keni vënë vulën e noterit, këtu duhet të kishte shpjegime se çfarë janë këto zëra.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Çfarë kishe pyetje konkrete?

Këshilltar E.Bregu: Dua shpjegimin pra, çfarë janë këto, të gjitha aktivet që ka futur, detyrimet e prapambetura që janë vendosur të shlyhen, çfarë janë të gjitha këto?

Këshilltare A.Përmeti: Ana mundem?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po.

Këshilltare A.Përmeti: Normalisht pasqyrat financiare kanë një element që thotë detajimi i të gjitha zërave ku jepen të detajuara të gjitha këto dhe në këtë rast raporti i auditimit nuk ka nevojë të përsërisë ato që janë në detajimin e pasqyrave që janë në fletën e fundit dhe për pjesën e detyrimit nëse i referohemi numrit 51 detyrimet tatimore, detyrime të prapambetura thuhet sa është gjendja në 1 janar 2024, sa janë shlyer në 2024, sa është gjendja në fund të vitit që normalisht edhe ky fitim do shkojë për shlyerjen e detyrimit që përsëri do shkojë pjesërisht sepse është 1 milion 745,290, ky është shpjegimi im në pjesën si anëtare e komisionit të financave.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje tjetër?

Këshilltar D.Osmani: Tani nuk është nevoja të mbrojë njeri nga këshilli materialin .

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem përfaqësuesit të dëgjojnë këshilltarët dhe të përgjigjen.

Këshilltar D.Osmani: Materialin nuk ka nevojë njeri nga këshilli të na i relatojë, as të na i mbrojë, ka përfaqësues nga ekzekutivi janë të nderuarat atje zonjat eksperte që janë shumë më të afta se gjithë ne këtu.

Këshilltare A.Përmeti: Z.Devi kam të drejtën time të jap shpejgimin.

Këshilltar D.Osmani: Të mbaroj fjalën të lutem, kemi thirrur këtu edhe drejtuesit e institucionit edhe zonjat e nderuara, është një material që për mendimin tim kërkonte shpjegime nuk është se është ndonjë aktivitet i madh i kësaj shoqërie por meqënëse më sfidoi pak edhe mikja ime Ada Përmeti. Të të pyes pak Ada këto shpenzimet e pazbritshme minus 2 milion e 400 mijë nga se përbëhen dhe cilat janë, mund të ma jepni një përgjigje?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kjo ishte pyetje për Adën, ka pyetje të tjera nga këshilltarët?

Fjala për përfaqësuesit.

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ja të mendohet dhe do ta japë.

Audituesja A.Çunoti: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltare A.Përmeti: Me leje znj.Ana.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se ishit të qartë.

Këshilltare A.Përmeti: E falenderoj Anilën për shpejgimin, dua të shtoj diçka për efekt të mikut tim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Devis Osmani.

Këshilltare A.Përmeti: Nuk ka nevojë ta përmend, pjesa e shpenzimeve të panjohura është dhe për efekt të tatimit të fitimit, pra në këtë moment prandaj quhen dhe shpenzime të panjohura lidhen me pjesën e tatimit mbi fitimin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 3

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 3 abstenim.

Pika 8 e rendit të ditës.

“SIPAS KËRKESËS TË SHOQËRISË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- PËR MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2024 TË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Gjithashtu dhe këshilli mbikëqyrës i Shoqëria Aksionere “Qendra Sportive Korçë” ka dërguar për miratim pasqyrat financiare të vitit 2024, komisioni dëgjoi dhe audituesit ligjorë në seancë dhe vendosi t’ja kalojë për miratim seancës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Po z.Bregu se kishit dërgua edhe diçka në email.

Këshilltar E.Bregu: Kjo është një kërkesë e vazhdueshme nga ana jonë në lidhje me Qendrën Sportive, informacion që kemi kërkuar vazhdimisht bashkisë dhe kryetarit të bashkisë sepse nëpërmjet kësaj qendre kalojnë disa fonde të cilët përfitues janë shoqëria e futbollit “Skënderbeu” që sipas përshkrimit atje thuhet në fakt stafi dhe ja kalojnë gjoja individëve po Bashkia Korçë është aksionere tek shoqëria e ekipit të futbollit “Skënderbeu”, shoqëria profesioniste. Ju kujtojmë të gjithë të pranishëmve që ky ekip luan në kategorinë superiore dhe është në nivel profesionist. Informacioni që ne kemi kërkuar nuk na ka erdhur asnjëherë përgjigjia dhe kryetari i bashkisë para nja dy muajsh na ka thënë se i kemi bërë kërkesë aksionerit mazhoritar por ai ende nuk na është përgjigjur edhe pse ju keni të drejte tha që ai duhet të ishte përgjigjur më shpejt por unë mesa shoh ai as sot nuk ka kthyer përgjigje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Tani keni pyetje?

Këshilltar E.Bregu: Pyetja bëhet pasi shtrohet informacioni, si mund t’ja shtronim paraprakisht ekspertëve dhe administratorit të Qendrës Sportive Korçë të cilët duhet të na përgjigjem. Nëpërmjet kësaj shoqërie bilanci i pasqyrave financiare kalon shuma prej të paktën 200 mijë euro që përfitohet nga stafi i futbollit, kur thamë ne se tek ekipi i futbollit “Skënderbeu” jemi aksionerë. A duhet që kjo shumë të kalojë nëpërmjet kësaj shoqërie apo te shoqëria e ekipit të futbollit “Skënderbeu” dhe ekspertët pa e ditur këtë informacion kur e marrin shumën që ka kaluar te ky bilanc e kontrollojnë dhe thonë që duket në rregull. Ne jemi aksionerë tek shoqëria e futbollit “Skënderbeu” ekspertët duhet të na japin një përgjigje të analizuar dhe dedikuar për këtë çështje, kjo shumë duhet të kalojë nëpërmjet këtij bilanci apo ndonjë shoqërie tjetër?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje të tjera?

Këshilltar L.Petri: Doja të dija nga ekspertët se çfarë opinion apo qëndrimi mbajnë në lidhje me Sport Klub “Skënderbeu” i cili ushtohet privatisht dhe në dijeninë time menaxher është dhe nënkryetari i Bashkisë Korçë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje të tjera?

Këshilltar D.Osmani: Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare unë përgëzoj zonjat e nderuara sepse pasqyrat dhe informacioni ishin korrekt të gjitha. Unë kam disa pyetje me drejtuesit e institucionit të cilën për mendimin tim këtë rradhë që është dorëzuar bilanci ne nuk i kishim por një sygjërim dhe një kërkesë do të ishte që kur të vijë sepse vitet vijnë dhe ikin shpejt por mirë do ishte që atyre pasqyrave financiare ti bashkëngjitin edhe shpjegimet për zërat përkatëse për sa i përket shpenzimeve, sepse nëse ne do kemi pyetje do kemi pyetje për këto shpenzime që janë bërë dhe ku janë bërë destinacioni sepse sipas pikave këtu në shpenzimet e shfrytëzimit janë shumë të thata dhe ne nuk mund të kemi një informacion të saktë sa drejt janë shpenzuar financimet tek kjo pjesë dhe taksat e qytetarëve Shqiptarë. Shikoj edhe një zë të cilën mbaj mend e kemi diskutuar edhe vjet i cili zë peshën kryesore dhe është ujë, oshe dhe gaz-naftë që të dyja bashkë shkojnë rreth 13 milion lekë të reja në vit të cilat kisha një pyetje sepse është diskutuar vitin

e mëparshëm për tu parë mundësia me financime për fotovoltaike të paktën të kursehet një pjesë e këtyre shpenzimeve nëpërmjet ngrohjes apo shfrytëzimit të energjisë diellore dhe me sa kam kuptuar ka qënë e mundur, ka ndonjë projekt të na i bëjnë me dije dhe mund ta zhvillojmë për vitin në vazhdim apo jo?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit atëherë dëgjojmë shpjegimin.

Ekzekutivi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem këshilltarëve kërkon fjalën pastaj flisni.

Këshilltar E.Bregu: Nuk e mora përgjigjen e plotë, mund ta specifikoj pak pyetjen?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë ju lutem.

Këshilltar E.Bregu: Mendoj se nuk e mora përgjigjen e plotë, referuar vendimeve të vitit 2019 dhe janar 2025 kalimi i fondit nga bashkia tek shoqëria mund të duket korrekt dhe për këtë nuk kemi kundërshtim, pyetja që unë kam dhe jam i paqartë është se ky fond duhet të kalojë direkt në llogarinë e personave apo duhet të kalojë tek bilanci i shoqëria "Skënderbeu" ku Bashkia Korçë është aksionere dhe pastaj tu kalojë si shpenzim i dedikuar për çfarë është për llogaritur shpenzimi sepse shpenzimi kalon nga bilanci, nga kjo shoqëri direkt tek individët, por meqënëse jemi aksionerë aty unë mendoj që kjo shumë duhet të kalojë te Shoqëria "Skënderbeu" pastaj tek shpenzimet e përcaktuara. Kjo është pyetje ime, ju si eksperte si e konideroni këtë?

Ekzekutivi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar E.Bregu: Ju lutem këshilli i bashkisë nuk ka thënë që do ju kalojë në llogari personale, thjesht financohet.

Ekzekutivi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar E.Bregu: Ne nuk po kërkojmë ndryshimin e aktivitetit, ne po pyesim kalimi i fondit nga shoqëria tek individë nuk është e përcaktuar nga këshilli i bashkisë.

Ekzekutivi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar E.Bregu: Dhe në statutin e shoqërisë thuhet se duhet t'ju kalojë në llogari personale atyre?

Atje thotë thjesht financimin e këtyre ekipeve dhe ekipit të futbollit "Skënderbeu" por nuk thotë financimin e personelit, ndaj meqënëse thotë se financimin e ekipit të parë të "Skënderbeut" ajo duhet të kalojë tek shoqëria sepse ekipi i parë nuk janë individët por janë shpk apo sh.a nuk e di si është tamam sepse kryetari i bashkisë nuk ka sjellë ende informacionin e shkruar që ne t'i referohemi në mënyrë zyrtare se çfarë është. Prandaj pyetja tonë është duhet t'ju kalojë individëve apo shoqërise?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ja u dha përgjigjen tre herë.

Këshilltar E.Bregu: Ju nuk keni të drejtë ta përcaktoni këtë nëse është korrekte apo jo?

Ekzekutivi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar E.Bregu: Pyetja ime është duhet t'ju kalojë shoqërisë apo individëve?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë ja u dha përgjigjen, ju pëlqeu apo jo përgjigja.

Këshilltar E.Bregu: Jo nuk e kam marrë këtë përgjigje, duhet t'i kalojë shoqërisë apo individëve?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është brenda aktivitetit po thotë.

Ekzekutivi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.)

Këshilltar E.Bregu: Me këtë statut, ju kalon individëve apo shoqërisë?

Ju thoni i kalon individëve është korrekte, ta marr të mirëqënë që duke thënë se ju kalon individëve eksperti ka dhënë përgjigje korrekte?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem këshilltarëve.

Ekzekutivi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.)

Këshilltar E.Bregu: Pyetja ime është duhet të kalojë në formën një apo dy?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem, ju dha përgjigje, ka diskutime?

Këshilltar L.Petri: Falenderoj ekspertët për punën që kanë bërë dhe kohën, ndonse unë pyetjen që bëra nuk mora përgjigje dhe po e shtroj në diskutime dhe duke thënë që sado komfort standarteve të kontabilizuara të jenë dhe korrekte në kalimin e fondeve e marr të mirëqënë se janë kështu mua nuk më ngjit se këtu kam para një fletë të firmosur ku thotë kryetari i këshillit mbikëqyrës Kletjon Kita i cili është dhe nënkryetar bashkie dhe nga ana tjetër rezulton dhe menaxher i Sport Klub "Skënderbeu" ju nuk ju nuk ju bën përshtypje kjo?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kush është Sport Klub "Skënderbeu"?

Këshilltar L.Petri: I referohem asaj që ka qënë historikisht menca e sportistëve që sot është bërë lokal.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po edhe?

Këshilltar L.Petri: Dhe mund të pyesni kryetarin sepse atje punon.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo po të pyes ty tani sepse kur i ve këtë emrin Sport Klub "Skënderbeu", është entiteti?

Këshilltar L.Petri: I referohem objektit atje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të lutem tani objekti është objekti, tani Sport Klub "Skënderbeu" është ndonjë entitet juridik, sh.p.k,sh,a?

Këshilltar L.Petri: Është objekt pranë Parkut "Rinia" dhe sot më rezulton se është lokal dhe menaxhohet nga nënkryetari i bashkisë që e keni ju në varësi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po çfarë këto menaxher, menaxhon ku e keni këtë informacion?

E para kur thua se është menaxher se na konfuzove thamë çfarë është ky entitet i ri Sport Klub "Skënderbeu" i vure një emër një godine dhe unë e kuptova sikur ishte ndonjë entitet ndonjë subjekt juridik.

Këshilltar L.Petri: Jeni i qartë z.kryetar?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo nuk jam i qartë me këtë menaxher, ku e ke parë në listën e pagave të tatimeve?

Këshilltar L.Petri: Ka një aktivitet privat.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal ku e ke parë këtë?

Këshilltar L.Petri: Ju mund ta mbronit gjithë ditën, unë po ju them se e ka.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk po mbroj asnjë, po kërkoj informacion se nuk e kam.

Këshilltar L.Petri: Mund ta kërkonit tek institucionet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: O z.këshilltar tani ngritët një çështje po thua se nënkryetari i bashkisë është menaxher i një subjekti tregëtar, nga e keni këtë informacion ju lutem?

Këshilltar L.Petri: Ju po bëni pyetje retorike tani apo?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo po bëj pyetje të drejtpërdrejtë dhe dua përgjigje, ku e keni këtë informacion?

Këshilltar L.Petri: Unë pyeta ekspertin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Këto janë fjalë pazari për këto duhet të shkosh tek kafeneja e lagjes, ekspertja shikon letrat e një shoqërie.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem, nuk ka lidhje me materialin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Z.Lazjon meqënëse e ngrite si pyetje dhe më intereson ta di ku e keni ju këtë informacion që nënkryetari i bashkisë është menaxheri i Sport Klub "Skënderbeu", se çfarë u bë këshilli na vini na bëni nga këto muhabete që dëgjoni në kafenenë e lagjes.

Këshilltar L.Petri: Z.Kryetar unë nga rruga vij ju jeni në institucion.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ti mund të vish nga rruga por kur vjen ulesh je përfaqësues, këshilltar në këshillin bashkiak dhe gjërat nuk thuhet kot por kur thua diçka na thuaj e ndonjë argument nga mbrapa.

Këshilltar L.Petri: Unë ja u them dhe në sy, ju nuk ju bën përshtypje kjo gjë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ore ma jep saktë që pastaj të më bëjë përshtypje.

Këshilltar L.Petri: Çfarë fakti do më, ja ku thotë kryetar i këshillit mbikëqyrës Kletjon Kita.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Menaxherin më thuaj.

Këshilltar L.Petri: Z.Kryetar mund të na lejosh të flasim?

Këtu thuhet kryetari i këshillit mbikëqyrës i cili është dhe nënkryetar i bashkisë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Deri këtu dakort.

Këshilltar L.Petri: Është i njëjti person i cili një objekt që lidhet me aktivitetin sportiv, lidhet me sh.a në fjalë ai sot punon për një klub ju nuk ju bën përshtypje kjo gjë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Çfarë lidhje ka nënkryetari i bashkisë?

Po thua që një person i cili ka një funksion publik pra është nënkryetari i bashkisë dhe kryetar i këshillit mbikëqyrës është menaxher, ju lutem ku e keni dokumentin?

Dy të para mi tregove i di, po i treti?

Këshilltar L.Petri: Z,kryetar ju mund të kërkonti edhe dokumentin e dokumentit.

Dokumentin e di e gjithë Korça.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ok e kuptova.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Duhet ti përmbahemi rendit të ditës, besoj se shpejgimi nga ekspertët ishte i plotë, i qartë, e hedhim në votim, kush është dakort?

Këshilltar D.Osmani: Përgjigjet e pyetjeve të mia.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare respektoni procedurën.

Këshilltar D.Osmani: Kam bërë disa pyetje nuk mora përgjigje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Aq kishin mundësi mbase ju doni të rrini gjithë natën, si doni ju.

Këshilltar E.Bregu: A ka diskutime sepse pas pyetjeve rradha ju vjen diskutimeve, pastaj hidhet në votim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Së pari bashkë me pyetjet bërë dhe komentet siç doje ti, nuk të ndërpreva.

Këshilltar E.Bregu: Komentet i shtrova para pyetjes për të kuptuar pyetjen ata që do sqaronin situatën. Ke frikë të lejosh diskutimet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.)

Këshilltar E.Bregu: Po bëri Lazjoni duam të bëjmë e ne, ne kemi rradhën e diskutimeve dhe ti nuk na ke dhënë fjalën.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po adresoni pyetje që nuk kanë lidhje.

Këshilltar E.Bregu: Na lejoni të diskutojmë atëherë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë ju në diskutimin tuaj.

Këshilltar D.Osmani: Nuk mora përgjigje.

Këshilltar E.Bregu: Këshilltari D.Osmani thotë se nuk ka marrë përgjigje ende, mbaro me pyetje përgjigje pastaj fjala për diskutime, po shkel procedurën si kryetare e këshillit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jo nuk po e shkel, mos mbivendosni zëra, kam kërkuar të bëni pyetje së bashku me pyetjet për ekspertët keni bërë si e keni menduar ju, thashë fjalën për diskutime.

Këshilltar E.Bregu: Jo është gënjeshtër nuk na dhe fjalën për diskutime ne kemi bërë shtrim paraparak para pyetjeve.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Lazjon kur të dhashë fjalën, ta dhashë për diskutim?

Këshilltar D.Osmani: Nuk i janë përgjigjur pyetjeve, janë bërë disa pyetje nga ana ime dhe nuk kam marrë përgjigje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po të them ndërtuat pyetjet dhe aq mundësi dhe procedurës që kanë ekspertët ju përgjigjën dhe thanë tre herë përgjigjen e tyre, ju mund të doni ta çoni ujin atje ku doni ju por ekspertët i mbaruan komentet e tyre.

Këshilltar D.Osmani: Nuk është çështje uji.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem ta mbaroj fjalën, i mbaruan në momentin që unë ju thërras ju për të diskutuar i vetmi që kërkoi fjalën ka qënë Lazjoni dhe unë ja dhashë.

Këshilltar L.Petri: Kanë dhe kolegët diskutime znj.kryetare mund t'ja u lesh fjalën?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ndaj kjo është arsyeja, kur kërkova për të diskutuar jam shumë e vëmendshme dhe i vetmi që ngriti dorën ishte Lazjoni dhe e quajta të ezauruar këtë pjesë sepse ju së bashku me pyetjet bëtë dhe diskutimet tuaja, pyetje-përgjigje me ekspertët pa kërkuar leje.

Këshilltar D.Osmani: Nuk bëra diskutime.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem të dëgjova më dëgjo dhe mua dhe kjo ishte arsyeja që nuk kam shkelur procedurë por i kam dëgjuar këshilltarët dhe i kam parë me vëmendje se kush donte të diskutonte. Nëqoftëse ju keni akoma të shpreheni akoma për të diskutuar përveç atyre që diskutuat patjetër unë po e anulloj votimin dhe po ja jap fjalën të diskutoni dhe mos ndërtoni pyetje jashtë rendit të ditës.

Këshilltar D.Osmani: Jo pra absolutisht kam bërë pyetje dhe po pres përgjigje, besoj se drejtuesi i institucionit do na thotë e para që mos ngatërohemi pyeta për disa shpenzime për ti patur të detajuara dhe për bilancin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju drejtuat ekspertëve.

Këshilltar D.Osmani: Jo pra me ekspertët mbarova punë, nuk kisha ndonjë pyetje për ekspertët.

Luisi mbajti pak shënim, e paralidhet me shpenzimet e detajuara sepse ne shohim vetëm shifra dhe një emërtim të zërit përkatës, e dyta ishte për fotovoltatikët.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Për fotovoltaikët.

Këshilltar D.Osmani: E shikon e mbani mend dhe ju.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E mbaj mend si jo.

Këshilltar E.Nexhipi: Që mos i keqkuptojmë, zonjat janë shumë të nderuara, profesioniste mos i futim në debatet tona politike.

Këshilltar D.Osmani: Nuk ka lidhje me politikën.

Këshilltar E.Nexhipi: Ti ndajmë pyetjet ato që janë të karakterit menaxherial dhe ato që janë procedural për ekspertët. Nuk e kam për ju z.Devi por e kam të përgjithshme sepse mori karakter tjetër dhe nuk mund t'i vendosim ekspertët të paktën unë i besoj dhe procedurat e tyre janë të qarta dhe specifikojnë veprimet janë në përputhje me ligjin, me vendimet tona këtu, me vendimet e bordit dhe me punën e administratorëve kaq pyetje mund t'ju bëjmë ekspertëve pastaj për pjesën menaxheriale të aspektit e kemi me elektrik nga rrjeti apo nga panelet, apo nga hidrocentrali është tjetër diskutim.

Këshilltar D.Osmani: Patjetër nuk ju drejtova ekspertëve .

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ndaj ju ftova në votim.

Këshilltar D.Osmani: E pyeta Luisin si drejtues institucioni, e para njëherë shpyqyr i kemi zonjat eksperte dhe na kanë ngelur sepse sipas shenjave a do ngelet ndonjë ekspert.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ndaj ju ftova në votim.

Këshilltar D.Osmani: Mirë pra por ishin disa pyetje që nuk mora përgjigje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Përfaqësuesit janë këtu por ne miratojmë pasqyrat financiare që kanë përgatitur ekspertët, atëherë do i miratojmë këtu dhe më pas vazhdo pyetjen këtu i kemi.

Këshilltar D.Osmani: Si të doni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 5

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 30 këshilltarë, 24 pro, 1 kundër, 5 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Vazhdoni me pyetjet të merrni përgjigje

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio,flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: (Nuk ka audio,flet pa mikrofon.)

Këshilltar E.Bregu: Ekspertët mund të ishin larguar pasi mbaruan pyetjet teknike, në diskutimet tona nuk kishin pse të rrinin ekspertët.

Ekzekutivi L.Qirinxhi: (Nuk ka audio,flet pa mikrofon.)

Këshilltar D.Osmani: Ja pra këtë doja unë, e kam përsëritur 100 herë përveç pjesës politike jemi dhe qytetarë tani. Tani 35 milion lekë të reja kushton sipas pretektivit apo parashikimit që ka bërë drejtori tani unë konstatoj se në një vit harxhon 8.5 milion lekë apo jo?

Përafërsisht 8 milion sepse ndoshta ke dhe ujin këtu brenda por nuk besoj se uji zë ndonjë peshë, meqenëse zonjat janë këtu unë besoj se brenda 4 vitesh ky investim del fitimprurës dhe bashkia pas vitit të 4 ka 8 milion lekë plus për t'i shpenzuar për diçka tjetër apo e kam gabim këtë?

Ekzekutivi L.Qirinxhi: (Nuk ka audio,flet pa mikrofon.)

Këshilltar D.Osmani: Prandaj janë 25 vjet me garanci besoj unë apo 30, po themi brenda vitit të katërt plus-minus kjo pjesë e energjisë elektrike që ju harxhoni sot dhe paguani oshe-së mund të jetë e rikthyheshme, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, kanë erdhur 3 kërkesa njëra është me të njëjtën tematikë, njëra nga tre këshilltarë të këshillit bashkiak dhe njëra nga një qytetar z.Jorgo Braholli kërkesa për shpalljen e gjëndjes të fatkeqësisë natyrore dhe dëmshpërblimin e fermerëve për dëmet e shkaktuara ne fruti- kultur pas ngricave të datave 7,10 prill 2025, kërkesa është depozituar nga këshilltarët Alketa Zheku, Devis Osmani dhe Irvin Bode kërkojmë që kjo kërkesë t'i drejtohet këshillit bashkiak, kryetarit të bashkisë dhe kryetares të këshillit. Së pari njëherë këshilli nuk ka tagrin që të miratojë një vendim për shpalljen e fatkeqësisë natyrore por unë do doja një shpjegim shterues nga ekzekutivi, drejtorja juridike dhe kryetari i bashkisë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të jap unë një shpjegim në lidhje me këtë kërkesë të këtij grupi këshilltarësh dhe pastaj në rast se duhet informacion i detajuar kemi dhe stafin e bashkisë nga emergjencat civile dhe nga sektori i buqësisë. Tani është e vërtetë se para pak ditësh u përballëm si zonë me një situatë

të pazakontë të motit me rreshje bore dhe shoqëruar me temperatura të ulta të cilat krijuan problematika në prodhimet buqësore sidomos në pjesën e pentarisë. Hapat që u morën nga ana e bashkisë, e para është evidentimi në terren nga ana e Thanasit e përgjegjësit të sektorit të buqësisë të zonave apo tokave buqësore ku pretendohej për dëmtim, u verifikuan këto sipërfaqe dhe niveli i dëmtimit që për hir të së vërtetës ishte i konsiderueshëm dhe ky informacion i është përcjellë institucionit të Prefektit bazuar dhe në kërkesën që kemi marrë nga ky institucion. Ajo që më është thënë edhe nga ana e specialistëve që edhe mund ta konfirmojnë është shkaku i saktë i dëmit do duket diku nga data 25 maj ku do jetë ai momenti i saktë i lidhjes të kokrrave, tani mund të bëhet një vlerësim i përafërt i dëmit, këto janë hapat që kemi ndërmarrë pra verifikim në vend dhe dërgimi i informacionit tek institucioni i Prefektit, ndërkohë situata reale do duket diku rreth datës 15 maj. Ajo që dua të them është se ju e dini sepse këtu jetoni këto situata përsëriten nga viti në vit me ndryshimin e motit me ngrohjen globale janë bërë edhe më të paparashikueshme këto fenomene si ngrica, breshëri që shkaktojnë dëme në buqësi sidomos në pjesën e penatarisë, nga informacioni që unë kam dhe kjo do jetë shumë pozitive për ta adresuar këtë problematikë në momentin që do ndodhë Ministria e Buqësisë është duke ndërmarrë një nismë për të hartuar një kuadër ligjor, një ligj për sigurimin në sektorin e buqësisë, sigurim ku besoj dhe shteti do marrë përgjegjësinë e tij në përballimin e pagesës të kostos të primit të sigurimit dhe kjo është zgjedhja besoj unë më e mirë për fenomene që ndodhin. Patjetër që një rol për të parandaluar dëmtimin nga disa fenomene atmosferike siç mund të jetë breshëri është dhe pajisja e pentoreve me rrjeta antibreshër edhe në këto masat e rradhës të mbështetjes të buqësisë besoj Thanasi është kjo mbështetja me antibreshër?

Ekzekutivi Th.Tona: Po është.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shpresoj se nga njëra anë rritet numri i fermave që sigurojnë këtë mbrojtje për një pjesë të fenomenit dhe nga ana tjetër zgjidhet problematika e sigurimit të produkteve buqësore për të mbrojtur fermerët nga kushtet e paparashikuara të motit, për fenomenin në fjalë të ndodhur para pak ditëve këto janë masat që kemi marrë deri tani.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, po z.Osmani.

Këshilltar D.Osmani: Faleminderit znj.kryetare, atëherë në lidhje me kërkesën që kemi bërë do ishte e udhës të kishim marrë një përgjigje zyrtare nga kryetari ose institucioni përkatës. E dyta përsa i përket konstatimeve që ju mendoni se do jenë pas datës 15 maj dhe ju mendoni sa pas datës 15 maj konstatimet do jenë në ato nivele që ne e kemi marrë informacionin apo ju e keni parë me ekspertët tuaj dhe do të kërkonit të vendosej kjo, domethënë t'i propozonit këshillit të ministrave zbatimin e kësaj pikës shpalljen e gjendjes të emergjencës të fatkeqësisë natyrore, sipas ligjit 45 2019?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani siç e keni thënë edhe ju tek ajo kërkesa që më keni drejtuar mua, siç e thashë unë, ka një rrugë që ndiqet për të miratuar gjendjen e fatkeqësisë natyrore, që do të thotë informacioni shkon nga bashkia tek Agjensia Kombëtare e Emergjencave Civile dhe pastaj miratohet me vendim qeverie.

Këshilltar D.Osmani: Pas datës 15?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal kjo është rruga që ndiqet në informacionin e kemi dërguar që tani tek Prefektuar që ka pasur dëme, kemi çuar informacion të plotë me sipërfaqe me numër fermerësh, me zonat ku janë përqëndruar vendimet, por nga ana e specialistëve më është thënë sepse unë nuk jam agronom do duket më vonë kur të kryhet lidhja e kokrrës, por që ka dëm patjetër ka, informacionin e kemi dërguar institucionet do ta vlerësojnë me rradhë sipas kësaj rruge që e citova.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit,këto ishin dy kërkesat dhe përgjigjen e morët nga ekzekutivi unë do doja përsa na përket ne si këshilltarë ne nuk e kemi tagrin për të marrë një vendimmarrje në këshill për shpalljen e gjendjes të fatkeqësisë. Kalojmë në të ndryshme ka diçka?

Këshilltar E.Bregu: Ne e kuptojmë shumë mirë që këshilli nuk e ka kapacitetin për të marrë masa për këtë çështje e kemi diskutuar dhe në mbledhjet e kaluara fenomenet atmosferike dhe rrezikun e prodhimit buqësor dhe faktin se fermerët dhe blegtorët nuk kanë garanci për prodhimin dhe çështja që kemi diskutuar këtu është se ata duhet të sigurohen që t'i bëjnë ballë fatkeqësive natyrore. Kompanitë e sigurimit nuk e marrin përsipër sigurimin për fatkeqësitë natyrore për shkak të disa procedurave që ata kanë ose më mirë të themi nuk e marrin përsipër, ndaj sot e themi që janë 34 vjet pas 90-tës të qeverisjes demokratike dhe 12 vjet që i premtojnë fermerëve se prodhimet e tyre do kenë garanci dhe do tregëtohen dhe në Evropë dhe mbarë Botën Perëndimore ne nuk ju garantojmë dot fermerëve që të sigurojnë prodhimin. Pra kjo është një fatkeqësi e cila vjen dhe për shkak të qeverisjes, duhen marrë masa urgjente bazë e rrejtit rregullator me qëllim që kompanitë e sigurimit të marrin përsipër për sigurimin e prodhimit, në këtë mënyrë ju japim një shtysë dhe fermerëve që të investojnë në sektorin e buqësisë dhe blegtorisë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, në të ndryshme ka diçka?

Këshilltar K.Pllaha: Kam dashur ta marr fjalën gjatë debateve por nuk mu dha mundësia të kem vëmendjen tuaj për të shprehur një opinion, jo diçka madhore. Së pari dua të shpreh mendimin tim nga gjuha që u përdor në këtë mbledhje kryesisht.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem çfarë gjuhe u përdor?

Unë as kam fyer dikë, jam drejtuar me shumë kujdes.

Këshilltar L.Petri: Lere të mbarojë znj.kryetare sepse kolegu është shumë i qetë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem mos u kap, nëse keni diçka në të ndryshme ndonjë çështje ta ngrini. Çfarë gjuhe u përdor?

Këshilltar K.Pllaha: Dhe kjo që po bëni tani është një çështje intimidim, që të ndërpret.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk është çështje intimidimi, por mos u merrni me mua.

Këshilltar K.Pllaha: Nuk e kisha personalisht me ju por edhe me kryetarin e bashkisë në disa momente të caktuara që krijon një gjuhë dhe debat që nuk i shërben qëllimit që jemi këtu por rastisi që në këtë periudhë edhe ata që na dëgjojnë që nuk duhet të ndodhë. Një nga rastet që doja të merrja fjalën ishte çështje për aktivitetin e artistit që u mbështet nga Këshilli i Qarkut ku unë votova abstenim edhe për shkak sepse ka një mungesë transparence në përgjithësi në këto aktivitete, ne na vjen një buxhet total prej 500 mijë lekë në rastin konkret por në rastet e tejra ka qënë më shumë pa shpjeguar se ku shkojnë, kush i merr dhe nëse ka mungesë imagjino sa e madhe është mungesa e transparencës për qytetarët dhe unë mendoj se transparenca është në bazë të demokracisë. Tjetër që u bë është se u hap këtu padashje dhe u mbyll gjithashtu ishte fakti i eventeve artistike gjatë periudhës të fushtatë, unë nuk e di rastin në fjalë por besoj të gjitha eventet artistike qoftë ato të organizuara nga bashkia deklarohen në KQZ gjatë kësaj periudhe bashkë me pjesëmarrësit dhe kjo çështje diskutimi nuk është çështje që na takon ne si këshill por shkelje ligjore që evidentohet nga KQZ dhe merren dhe masa, nuk e di se për cilin event artistik po bëhej debati por po jap një informacion.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Unë do doja ta lexonit edhe njëherë procesverbalin në zbardhje.

Këshilltar K.Pllaha: Procesverbalin e kam lexuar e mbaj mend debatin por ideja është që këto lloj evente artistike të organizuara nga bashkia.

Këshilltar E.Nexhipi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar K.Pllaha: Debatin nuk e di për çfarë u bë, por nga debati që dëgjova midis jush dhe z.Osmani po e vë në dukje këtë fakt nuk është çështje për diskutim por menaxhohen nga tjetër kush.

Këshilltar E.Nexhipi: Unë e kuptoj që jemi dy javë para zgjedhjeve sidomos kandidatët për deputetë nga partitë e vogla e kanë merakun ku të ngrenë zërin sepse në takimet siç duket është pak e vështirë por ju lutem të bëhemi pak seriozë për çka po diskutojmë.

Këshilltar E.Bregu: Nëpër takime janë kandidatët e inkriminuar z.Nexhipi mjaftojnë ata të inkriminuarit atje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mos u merrni me njëri-tjetrin, merruni jashtë.

Këshilltar E.Nexhipi: Thelbi është mos harxhoni kohën nga këto triubuna por shkoni atje takoni njerëzit, bindini është më mirë se ky debat bosh këtu, jo nuk e di aktivitetin se cili është por është ligji kështu.

Këshilltar E.Bregu: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Diçka të vogël meqënëse më përmendi Klajdi dhe më vjen keq që iku, unë në pozicionin që jam edhe personalisht edhe individualisht edhe kur mos jemi në këtë pozicion e kam shumë këtë pjesën e etikës nuk është se mbahem për person që nuk i respektoj njerëzit, nuk e di ku e shkela unë por ajo që kam me merak në këto mbledhjet e këshillit ja u thashë edhe sot do ja u them edhe në vazhdim, unë do preferoja kur të ngrihet një çështje në këshill të ketë mbështetje mos jetë muhabet kafeneje, jemi në këshillin e bashkisë Korçë jo në kafene, në kafene hajd ulemi unë me miqtë e mi mbajmë disa njerëz nëpër gojë dhe ju me miqtë tuaj mbani disa njerëz dhe e vetmja gjë që thashë është kur u përmend një rast konkret u tha filani ka një konflikt, ka një, dy pozicione publike ka dhe një pozicion në një entitet privat dhe thashë të lutem për këtë pozicionin e entitetit privat ke ndonjë letër, as e ngrita zërin. E dyta meqënëse e lamë tek të ndryshmet takimin me të rinjtë, ore se është kjo pjesa që tha Erjoni jemi në moment fushate dhe mund të rrimë gjithë ditën ne të themi disa gjëra, ju disa gjëra, ka qënë një takim mund ta konfirmoni edhe me të rinjtë atje nuk është bërë asnjë bisedë politike, as janë përmendur partitë, as ju është përmendur fushata, as ju është kërkuar të votojnë x apo y, ka qënë një bisedë e lirë në kafene, jo takim i organizaur, na kanë pyetur për disa gjëra kemi pyetur disa gjëra, kemi ndarë opinionet pozitive, negative disa gjëra kanë qënë mire disa keq, bisedë e lirë në kafene. Tani edhe bisedat e kafenesë do i politizojmë?

As kemi thirrur njeri me zor, as kemi detyruar njeri të vijë, as na kanë parë dhe i kemi mbajtur me zor dhe kryesorja as nuk kemi bërë një bisedë politike, zero fare.

Këshilltar D.Osmani: Tani po thua që bisedat e kafeneve i hidhni nëpër rrjetet sociale ju?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në raste të caktuara, unë nuk kam hedhur gjë por disa herë kur duket me interes edhe i hedhim, në varësi të temës dhe mendoj se ka ndonjë interes në rrjetet sociale.

Këshilltar D.Osmani: E para jemi në kohë fuashte, jemi. E dyta ishte një takim që e kishte thirrur drejtoresha e institucionit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ore tani, takimi në kafene nuk drejtohet nga drejtoresha.

Këshilltar D.Osmani: Zonja në fjalë ka një grup që ka ftuar të rinjtë tani, regjisor, aktor çfarë është ai që e ka bërë këtë. Tani do vazhdojmë ta bëjmë publike gjithë bisedën hajd e bëjmë dhe në se ju si kryetar kishit për të marrë ata fëmijë atje duke qënë se ishte dhe z.Peleshi atje po të ishte në një ditë të zakonshme ok sepse nuk do detyrojmë njerëzit të ulen apo jo, sepse tani janë jo qytetare me kë pimë kafe. E para ta kërkoja, ja kërkoja dhe zonjës të mos përsëriten, ajo që u bë, u bë është e kotë të justifikoheni dhe ju dhe ne nuk ju kërkojmë llogari por po ju themi që mos i shfrytëzoni, kjo është.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk është problem që kërkon llogari sepse ti ke të drejtë të kërkohesh llogari por po them se kafeja në fjalë nuk ishte nga këto që mund të kërkohej llogari sepse nuk ndodhi asgjë që të cënonte fushatën.

Këshilltar E.Bregu: Ti bëj një pyetje të fundit kryetarit, pasi ai tha se e mban veten me etikë edhe ju referua Klajdit se e kishte gabim dhe duke referuar kësaj që e kundërshtoi Klajdin dua t'i bëj një pyetje. A e konsideron veten me etikë që në 29 dhjetor 2023 futi policinë në sallë kundër këshilltarit të opozitës dhe për të cilën sakrifikoi sekretaren e këshillit duke e detyruar kryetaren e këshillit që t'i bëjë vëretje me gojë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar E.Bregu: Kryetari po të dojë mund t'i përgjigjet pyetjes unë po e pres në mos përgjigjuni ju të tjerët si të doni, po të dojë të përgjigjet, po mos dojë le mos përgjigjet.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare nuk e di çfarë kishe sot me ne, por e vetmja fjali që e kërkoja fjalën për procedurë nuk e di për çfarë arsye bëre çmos mos na i jepje fjalën. Ju lutem këtë ja kërkoj edhe koleges Naçi me rregulloren e këshillit që ka pikë ku thuhet për konfliktin e interesit kur trajtohet një çështje për të cilën një nga këshilltarët ka konflikt interesi duhet të dalë jashtë votimit dhe nuk duhet të jetë këtu sot përshembull ishte z.Nexhipi me gjithë respektin, kur u trajtua pika për kalimin e fondit tek Ansambli "Skënderbeu" mendoj se nuk duhet të votonte, e njëjta gjë vlen kur votojmë për çështje të tërheqjes të çështjeve urbane z.Fezulla nuk duhet të jetë këtu kur votohet, për procedurë këtë kisha.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Nexhipi nuk i ka paratë e tij ato që të ketë konflikt interesi, i ka miratuar Këshilli i Qarkut jo z.Nexhipi.

Këshilltar L.Petri: Ja ta tregoj unë si është në rregullore edhe pastaj më thuaj dhe tjetra që për mua është shumë madhore e kam me z.kryetar unë e përmenda TAP-in dhe mbase ishte jashtë pikës të rendit të ditës por fjala TAP na lidhte aty. Z.Kryetar në datën 5 mars keni bërë një thirrje publike në faqen e bashkisë, unë kam qënë vetë atje dhe ishte vënë dryni dhe nuk ishte bërë asnjë njoftim pse ishte anuluar takimi me përfaqësuesit nga Socar, erdhën miqtëe mi ambientalistë nga Tirana posaçërisht morën rrugën dhe u ndjeva keq si korçar dhe nga institucioni ku unë jam pjesëmarrës që bën thirrje dhe nuk i del për zot dhe ve dhe një kartë atje që u anulua takimi. E dyta po atë ditë në mbrëmje është mbajtur një takim ku keni qënë ju të pranishëm dhe pjesëtarë të tjerë në një mjedis privat, këtë e quaj të papranushme dhe e treta u shty për 1 muaj më vonë dhe rezultoi se është kohë fushate dhe kur ishte z.kryeministër atje ju keni mbajtur dhe një fjalë dhe jeni promoncuar me një qëndrim që po ky investim do bëhet dhe paska një projekt për këtë por unë këtë e konsideroj shumë thelbësore sepse duhet të kalojë nga këshilli bashkiak diçka e tillë dhe unë propozoj se duhet të paraqiten të gjitha variantet sigurisht ka një vlerë të shtuar për disa aspekte si kundër ka disavantazhe por ka dhe projekt që mbahet në sirtar i cili është i 2022 bërë nga ekspertë austriake, kliente kanë pasur Beizhin dhe është për ngrohjen e qytetit të Korçës me energji të rinovueshme dhe mendoj qytetarët kanë të drejtë të marrin informacion dhe jo tu bëhet taksative që do merrni gazin dhe pikë, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Lazjon të falenderoj për pyetjen që bërë por nëse ne do të vazhdonim aty në atë pikë të rendit të ditës të shtonim edhe këtë që thatë tani, nuk përputhej me atë që ne po miratonim, ndaj unë ja u kërkoja me shumë qytetari që në fund të takimit do t'ja u jap fjalën edhe njëherë për të marrë përgjigje të shteruar nga kryetari i bashkisë, ne vetëm vonojmë njëri-tjetrin me fjalë se qëllimi arrihet, fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shumë faleminderit për pyetjet sepse është një mundësi shumë e mirë për të sqaruar disa pika projekti. Tani që mos ketë keqkuptime për qytetarët që mund të na dëgjojnë apo me të cilët mund të flisni po e nis nga kjo e fundit, asnjë qytetar nuk do detyrohet të marrë gazin, pra nuk është një gjë që do ju themi me zor do marrësh dhe do ngrohesh me gaz ne do e kemi si alternative, pra rrejtji do jetë i shtrirë kush do të lidhet do përdorë gazin, kush do drutë e zjarrit mund të vazhdojë t'i përdorë, ajo për të cilën unë kam punuar dhe më vjen shumë mirë që jemi kaq afër realizimit është që ne t'ju sigurojmë një alternative qytetarëve që të kenë ngrohje në dimër me çmime më të përballushme se energjia elektrike, dru zjarri, të jetë miqësore me mjedisin, të heqim smokun e druve të zjarrit në dimër dhe shumë e rëndësishme që e ka ky projekt dhe nuk e ka ai tjetri që ju e përmendët ai studimi është dhënia e një burimi energjie për industrinë, e thashë në fjala ime për mua rëndësia e këtij projekti është po aq sa në alternativën e ngrohjes për qytetarët, akoma dhe më e madhe për alternativën e energjisë për bizneset, kjo është dhe rëndësia strategjike e biznesit. Përsa i takon atij aktivitetit para një muaji po është e vërtetë, i njëjti aktivitet ishte parashikuar të ndodhte para një muaji por për shkak të axhendës të kryeministrit edhe zv.kryeministres që duhet të ishin prezent sepse është një projekt që pa mbështetje tani jemi në muaj fushate mund të thoni pse e thua por kjo është e vërtetë, pa mbështetjen edhe personale të themi të Qeverisë Shqiptare dhe kryeministrit Rama tek Presidenti Aliiev ky projekt nuk ka shans që të ndodhë sepse nga ana ekonomike nuk është projekt i rëndësishëm për kompaninë Socar. Kompania Socar e tha dhe kryeministri na i kanë thënë dhe përfaqësuesit e Socar edhe në takimet e tjera po hyjnë në këtë projekt jo për të fituar por që të demonstrojë një projekt pilot të gazifikimit në Shqipëri dhe përfitimet që vijnë nga një projekt i tillë për familjet dhe industrinë dhe shpyqyr zgjedhën Korçën. Qëllimi i kompanisë nuk është të fitojë, pra të dalë 0-0 dhe tregojë një projekt të gazifikimit, në një projekt të kësaj rëndësie patjetër i takon të jetë dhe kryeministri, nuk e kishte mundësinë të ishte para një muaji por tani dhe nuk është se eventit u bë në një ambient privat, ai i lançuar para një muaji kishte një axhendë të gjithën, takimin, konferencë për shtyp dhe një koktej në fund, tani meqënëse kishin erdhur ata përfaqësuesit e kompanisë edhe Socarit, kishte erdhur dhe drejtori i Tap i përgjithëshmi nga Zvicra thane të bëjnë pjesën e koktejt, pra nuk u zvëndësua eventit me një pjesë të mbyllur sepse ju po e thoni sikur unë dua ta mbaj të mbyllur këtë projekt, unë jo vetëm që nuk kam interes ta mbaj të mbyllur por dua a ka mundësi të takoj çdo banor të Korçës dhe çdo ambientalist të Tiranës t'i them sa mirë për këtë mundësi për të cilën kemi kaq kohë po punojmë ti thua erdhën këta dhe ju e bëtë të mbyllur, unë a kisha mundësi që të shtunë ta fusja gjithë Korçën tek ajo salla dhe ta dëgjonte por nuk e kisha mundësinë sepse aq ishin kapacitetet. Edhe dy fjalë për ecurinë e projektit edhe unë ju kam vënë në dijeni deri tani për hapat janë bërë dy studime të fleksibilitetit teknik dhe ekonomik, rezultatet janë pozitive, hapat e rradhës janë nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet dy qeverive shpresoj të ndodhë në maj, bërja e projektit teknik të zbatimit që do ndodhë në muajt në vazhdim dhe afatet për të cilat i tha dhe kryeministri është dhe angazhimi i presidentit Aliiev dhe kompania Socar e mori mesazhin në fund të këtij viti të fillojnë punimet, në fund të 2026 të përfundojnë punimet 12 muaj dhe në fillim të 2027 të kemi mundësi të aksesit në gaz, ata që do duan, kush qytetar nuk do të ketë akses në gaz do burime të tjera thjesht nuk do lidhet, nuk është investimi do bëhet kush do ta financojë apo kush do e realizojë.

Këshilltar L.Petri: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kush do e zbatojë fizikisht po thua investimin?

Këshilltar L.Petri: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ajo është pjesë e marrëveshjes ndërmjet dy qeverive, ta thashë hapi i radhës sepse momente sqarime anë nuk e kam problem. Të thashë hapi i radhës është nënshkrimi i marrëveshjes e cila shpresoj të nënshkruhet gjatë muajit maj, mundësisht momenti do jetë mbledhja e Komunitetit Politik European në Tiranë në 16 maj ku do të jetë i ftuar besoj edhe presidenti i Ajzerbaxhanit mund të firmoset kjo marrëveshja. Ajo që mund të diskutojmë pastaj në këshill dhe mund të ketë nevojë për vendimarrje që unë mendoj do ju ofrojmë familjeve për të bërë instalimet e brendshme pasi gazi ka nevojë edhe për instalime të brendshme një kaldajë dhe rrjetin e radiatorëve për të ngrihur gjithë shtëpinë, këtu mund të hyjmë në një marrdhënie që do e diskutojmë kur të vijë momenti si bashki, në partneritet dhe em bankat madje që mund të duan të përfshihen që t'ju krijojmë mundësi familjeve ta kenë këtë mbështetje fillestare duke e paguar me kështu në kohë por kur të jemi në këtë moment do e diskutojmë, faleminderit.

Këshilltar L.Petri: Z.Kryetar u përmend një shifër 44 milion euro, kush do e paguajë atë faturë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Sapo ta shpjegoja që këto detaje të financimit të projektit jashtë investimet brenda gardhit të shtëpisë do diskutohen tek marrëveshja, që nuk e dimë do jetë grant pjesërisht apo kredi me kosto të butë patjetër dhe do refeltohet edhe në çmimin e gazit që nuk do e marrësh me zor po të pëlqeu çmimi i gazit po, po mos të pëlqeu mos e merr vazhdo ngrohu me dru apo di unë me çfarë ngroheni ju në shtëpi. Ajo që unë kam negociuar vazhdimisht me kryeministrin, zv.kryeministren, përfaqësues të Socarit që është dhe interesi i tyre që duhet të jetë alternativa më e përballushme për ndryshe familjet nuk do lidhen po të mos jetë e përballushme, ne po përpiqemi që do jetë alternativa më e mirë për qytetarët.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit kryetar, atëherë ju falenderoj për këtë mbledhje të radhës të këshillit bashkiak dhe shpresoj të mos e ngrejmë zërin në mbledhjet e tjera, faleminderit.

SEKRETARE E KËSHILLIT

EVA NAÇI



KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

